

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shtetasi amerikano-iranian lirohet nga burgu në Teheran, por nuk mund të largohet nga Irani – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/shtetasi-amerikano-iranian-lirohet-nga-burgu-ne-teheran-por-nuk-mund-te-largohet-nga-irani/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	8 shtator 2026, 16:53:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 10:04:46 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f9d0f93ad5803cf38fe2ea41f96f8c6ad14c403559014cbc0c10aae249673de7
TEKSTI	1763043543836d6b9bb1e2640c87dfe67c867eac3868944143fd5472a216b388
PAMJA	43bf8f4aa67208a39172d78b017963c9dbcba67f85f3d012e24661e5eb5e2ca7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a8710e367e44fa4c1654e7eb1951f33f65406fc93e13cdc5551355c87708917c
E MËPARSHMJA	761f22fa20f88cfca47622747c07e5ae44e36caeb1e685f5f7b1d377f4e3491e
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a8710e367e44fa4c1654e7eb1951f33f65406fc93e13cdc5551355c87708917c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Shtetasi amerikano-iranian Kamran Hekmati është liruar nga burgu famëkeq Evin në Teheran, kanë thënë burime për Radion Farda, shërbim në gjuhën persiane i Radios Evropa e Lirë. Por, ai nuk mund të largohet nga vendi për shkak të një ndalimi për udhëtim.

Lirimi i tij ende nuk është konfirmuar zyrtarisht nga autoritetet iraniane.

Hekmati, i cili në mars u cilësua nga Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, si person i ndaluar padrejtësisht, besohet se është liruar më 5 shtator.

Lirimi i tij është raportuar edhe nga The Jerusalem Post, një media izraelite që citoi burime iraniane.

Hekmati, 71 vjeç, udhëtoi drejt Iranit në maj 2025 për të vizituar të afërmit, duke përdorur pasaportën e tij iraniane, dhe u ndalua nga autoritetet dy muaj më vonë.

Gjykata Revolucionare e Teheranit më pas e dënoi me katër vjet burgim për shkak se kishte udhëtuar në Izrael për një ceremoni fetare më shumë se një dekadë më parë. Mbajtësit e pasaportave iraniane nuk lejohen të udhëtojnë në Izrael.

Dënimi i tij më vonë u ul në dy vjet, pas një ndryshimi në ligjin që rregullon udhëtime të tilla.

Familja e Hekmatit ka shprehur vazhdimisht shqetësim për gjendjen e tij

5 Elbasani nuk ranë egnatia peson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

shëndetësore, duke thënë se ai vuan nga kanceri agresiv i fshikëzës së urinës dhe se gjatë paraburgimit i është mohuar qasja në trajtimin e duhur të specializuar.

Rasti është një nga disa raste që përfshijnë shtetas të dyfishtë iraniano-amerikanë, të cilët janë përfshirë në përdorimin nga Irani të ndalimeve arbitrare si mjet presioni diplomatik ndaj Perëndimit, praktikë që kritikët e kanë quajtur “diplomaci pengmarrjeje”.

Dena Karari, një tjetër iraniano-amerikane, u ndalua për pak kohë në Shiraz në vitin 2024 dhe u lirua me kusht, por iu ndalua largimi nga Irani për rreth 19 muaj. Ajo u përball me akuza, përfshirë “bashkëpunim me një qeveri armiqësore” dhe spiunazh, por përfundimisht u lejua të largohej nga vendi në korrik të këtij viti. Menjëherë pas largimit të saj, një gjykatë në Zahedan e dënoi atë në mungesë me pesë vjet burgim.

Reza Valizadeh, ish-korrespondent i Radios Farda, vazhdon të jetë i burgosur në Evin.

Në një telefonatë të regjistruar nga brenda burgut në qershor të këtij viti, ai i bëri thirrje qeverisë amerikane të siguronte ndihmë mjekësore për të dhe amerikanët e tjerë të ndaluar, duke thënë se katër shtetas amerikanë të mbajtur në Evin vuanin nga sëmundje të ndryshme dhe nuk kishin qasje në kujdes të duhur mjekësor.

Valizadeh dha dorëheqje nga Radio Evropa e Lirë në nëntor 2022 dhe u kthye në Iran në mars 2024 për të takuar familjen e tij.

Ai u arrestua në shtator të atij viti. Ai u shpall fajtor për “bashkëpunim me qeverinë armiqësore amerikane” dhe u dënua me 10 vjet burgim, si dhe me ndalim të banimit në Teheran dhe provincat fqinje, ndalim udhëtimi dhe ndalim dyvjeçar të anëtarësimit në parti ose grupe politike.

Ankesa e tij u refuzua./rel



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



BOTA

Trump i kërkon Zelenskyt të...

Xhuljana Zhuleku 8 minuta më parë



BOTA

Tragjedi! Përmbysët anija me pasagjerë,...

Xhuljana Zhuleku Dje 23:17



BOTA

Zjarr masiv në Kroaci, evakuhon 230...

Xhuljana Zhuleku Dje 19:36



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme,

Lajme

Politikë
Bota
Vendi

Programe

Programe
Seriale
Guida TV

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies

programme, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

Kronike

Video

Reklamo me ne

Politika editoriale

Lifestyle

Ekipi i Vizion Plus

Dërgo lajmin tënd

• LIVE

f

@

▶

♪

in

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.